

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

**Procesverbalet nga dëgjimet buxhetore për projekt buxhetin e komunës
për vitin 2024**

Gusht 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 05.07.2023, me banorët e këshillit lokal Stroc, të mbajtur në shkollën e fshatit me fillim nga ora 17:00.

Të pranishëm nga komuna ishin: Ilmi Azemi-asamblist në Kuvendin e Komunës, Behar Duraku-asamblist në Kuvendin e Komunës, Bastri Duraku-Sekretaria e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Ilmi Azemi**, asamblist në Kuvendin e Komunës, i cili para qytetarëve të pranishëm prezantoi buxhetin dhe projektet që janë planifikuar për këshillin lokal Stroc.

Më pas fjala kaloi tek qytetarët e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Behar Duraku, asamblist në Kuvendin e Komunës, të gjitha çështjet çka janë për rregullim të kanalizimeve vitin e kaluar dhe disa rrugë jo shumë të gjata siç është rruga “Ahmet Ademi” do të përfundojnë këtë vit.

Behar Duraku, kryetar i këshillit lokal Stroc, paraqiti kërkesat për 5 fshatra. Në fshatin **Stroc** kërkoj që të bëhet trotuari nga shkolla e Strocit në gjatësi 1 km rruga “7 Dëshmorët”, asfaltimet në rrugët “Halim Aliu 100 m, “Lan Aliu” 100 m, “Armend Aliu” 50 m, “Nexhmedin Duraku”, “Sahit Duraku”, “Xhafer Duraku”, “Arben Duraku” në gjatësi totale 100 m, “Kadri Duraku” 50 m, segmenti “7 Dëshmorët” 50 m, “Lan Aliu” rruga Perparim Aliut 100 m, “Lan Aliu” rruga Mexhid Duraku 100 m, ndriçimi në rrugën “Lan Aliu” 300 m. Në fshatin **Beçuk**, rruga “Rexhep Murati” 400 m dhe “Jahir Murati” gjatësi 400 m, ndriçimi në rrugën “Avdyl Haliti” 300 m. Në fshatin **Gllavat**, rruga “Rexhep Konjuhi” 100 m, “Driton Islam Hasani” 100 m, ndriçimi në rrugën “7 Dëshmorët” 300 m. Në fshatin **Bivolak**, rruga “Nazif Klinaku” 50 m, “Berishaj” 60 m, “Imer Saraçi” 100 m. Në fshatin **Zhilivodë**, rruga “Ahmet Krasniqi” rrugica Lutaj 150 m.

Arianit Jashari, monitorues dhe banor i fshatit Stroc, i njoftoj të pranishmit mbi rolin monitorues që Organizata ACCESS në partneritet me CIVIKOS kanë për dëgjimet buxhetore. U përmenden se të gjitha çështjet që janë në buxhet në dy vitet e fundit do të kryhen këtë vit, mirëpo për këtë bashkësi lokale ky përfshin 5 fshatra, ju nuk keni marrë me vete se cilat janë ato investime që janë në buxhet dhe do të kryhen këtë vit, në mënyrë që ta dinë edhe banorët se çka të kërkojnë tjetër dhe të mos përsëriten.

Rrahim Tahiri, banor i fshatit Stroc, tha se shkolla nuk ka trotuar dhe fëmijët janë të rrezikuar, rruga “7 Dëshmorët” që është 1.5 km, nuk po them që krejt të shtrohet në kocka e me u bë trotuar, por rreth shkollës 150 m të bëhet trotuar. Kanalizim nuk kanë shtëpitë tona në anën e poshtme në gjatësi 1.5 km në rrugën “7 dëshmorët”, kanalizimet tona derdhen në livadhe. Kemi mungesë të pijes, vetëm me rënie të lirë nga mali që e kemi, edhe ata herë ka ujë e herë nuk ka. Komuna në qeverisjen e kaluar para dy viteve e ka shti infrastrukturën e ujësjellësit, janë gypat deri tek secila shtëpi, por ujin se keni lëshu, nuk e di çka po bëni, është komplet infrastruktura e rregulluar por ujë nuk ka.

Ilmi Azemi, asamblist në Kuvendin e Komunës, tha se nuk ka pasur mundësi të lëshohet uji për shkak se Komuna ka pasur telashe me prokurim me disa firma, por tha se uji do të lëshohet këtë vit me patjetër.

Ahmet Haliti, banor i fshatit Stroc, kërkoi që të hapen dhe mirëmbahen kanalet kulluese në lagjen Haliti, Mustafa, Duraku, Tahiri, kanale të hapen se kur po ka vërshime po na hynë në oborre, shtëpia dhe nëpër bashqe.

Ajet Aliu, banor i fshatit Stroc, në lagjen Aliu tek Durakt, i kemi disa rrugica që krejt me i mbledh nuk dalin më shumë se 80-90m dhe janë të paasfaltuara. Po kërkoj që të hyjnë në buxhet dhe të asfaltohen për vitin tjetër. Jemi e vetmja lagje që nuk kemi ndriçim, jemi rreth 8 shtëpi.

Behar Duraku, asamblist në Kuvendin e Komunës, tha se për rrugët që po flet qytetari Ajet Aliu, nuk janë pronë publike, janë pronë private të banorëve dhe sugjeroi që t'i ktheni në Drejtori të Kadastrit në rrugë publike dhe atëherë intervenon Komuna dhe i rregullon.

Habib Mustafa, banor i fshatit Stroc, tha se lapidari i të gjithë dëshmorëve është rregulluar "Batalioni i parë Brigada 142". Mungon ndriçimi dhe infrastruktura përreth, rrethimi i hapësirës dhe mirëmbajtja e saj, është duke u dëmtuar edhe nga shtazët.

Ali Jashari, banor i fshatit Stroc, tha se kanë ndriçim publik që është bërë para 3 viteve, po në shumë lagje nuk po punojnë drita, nuk ka mirëmbajtje të dritave në lagjet Jashari, Hasani, Aliu, Selimi, Isufi, pra po kërkoj me u ndërru dritat dhe të mirëmbahen.

Hysni Hasani, banor i fshatit Stroc, tha se rruga "Maliq Hasani" dhe "Ahmet Ademi" që dy vite rregullisht bëjmë kërkesë, asnjëra nuk janë rregulluar. Për rrugën "Ahmet Ademi" që lidh dy fshatra edhe vjet keni thënë që do të kryhet, por nuk u krye, po shpresojmë që këtë vit kryhet. Rruga "Daut Jashari" është me plot gropa dhe dëmtim të asfaltit, kërkoj mirëmbajtje. Kurrë nuk ka pas mirëmbajtje prej kur është shtruar asfalti që 12 vjet.

Arianit Jashari, banor i fshatit Stroc, tha se kërkesa e tij nuk është edhe aq elementare sa ishin kërkesat e parafolësve tjerë. Ju e dini që ne e organizojmë festivalin tradicional "Strofc i Jehon" tash e 7 vite, me diasporë dhe shoqata kulturore, kemi kërkuar dhe prapë po kërkojmë që të vendoset në buxhet që vendi ku mbahet festivali të zgjerohet rruga malore deri te vendi rreth 300 m, vetëm zgjerim dhe shtrim me zhavorr, të bëhet një parking aty afër vendit vetëm rrafshim i hapësirës dhe shtrim me zhavorr. Ndërsa, vendi "Logu i Kishës" të rregullohet me bager, të rrafshohet dhe të ndërtohet një amfiteatër klasik me kapacitet rreth 250 ulëse, nga druri dhe guri. Kjo për faktin se ky festival është shumë i rëndësishëm në aspektin kulturor, por edhe krijon ura bashkëpunimi mes artistëve dhe diasporës dhe mundësi për investime në vendlindje.

Ilmi Azemi, asamblist në Kuvendin e Komunës, tha se nuk po e fusin në buxhet këtë kërkesë sepse është telashe të realizohet, por po ju sugjeroj që ta përgatisni projektin dhe të kërkonit bashkëfinancim nga Komuna deri në 20% dhe Komuna e merr përsipër që me investu, sepse Zyra e Kryetarit ka buxhet për projekte investuese kapitale dhe me bashkëfinancim kryhet për vitin tjetër.

Procesmbajtës:

Bastri Duraku





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 07.07.2023, me banorët e keshillit lokal Novolan, të mbajtur në shkollën e fshatit me fillim nga ora 17:00.

Të pranishëm nga komuna ishin: Melihate Basholli Latifi-kryesuese e Kuvendit të Komunës, Albulena Tahiri-zyrtare në Drejtorinë për Buxhet, Financa dhe Thesar, Albiona Isa-asistente e kryetarit të komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Melihate Basholli Latifi**, kryesuese e Kuvendit të Komunës, e cila para qytetarëve të pranishëm prezantoi buxhetin dhe projektet që janë planifikuar për keshillin lokal Novolan.

Më pas fjala kaloi tek qytetarët e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Nexhmedin Tahiri, banor i fshatit Novolan, kërkoi asfaltimin e rrugës “Esat Tahiri” me gjatësi prej 140m. Asfaltimin e rrugës “Haxhi Dini” me gjatësi prej 100m. Rruga “Ilaz Hajrizi” dhe “Çlirimtarët”, gjithashtu shtrim me asfalt. Vetëm lagjet Ademi dhe Zymeri kanë mbetur pa kanalizim, gypat janë por nuk janë funksional. Ka dy vite që një shtëpi është pa rrymë dhe gjithashtu është e vetmja në fshat. Shtoi se KEDS ka problem me pronarin.

Fatmir Kovçi, banor i fshatit Novolan, tha se ka filluar renovimi i ËC-ve të shkollës, por janë ndalë punimet nga Operatori Ekonomik, ai gjithashtu shtoi se nga shiu janë prishur muret si edhe nga neglizhenca e Operatorit Ekonomik. Platoja para shkollës është e dëmtuar, parkingu i nevojshëm për shkollë, tabelat e shkollës janë të vjetra si dhe lyerja e mureve është e nevojshme, meremetimi i kulmit të shkollës dhe trotuaret në lagjet e fshatit.

Arben Hajrizi, banor i fshatit Novolan, tha se rruga “Bislim Vatovci” duhet asfaltuar dhe futur kanalizimi së bashku me ndriçim me gjatësi prej 260m. Rruga “Guria” duhet asfaltuar dhe futur kanalizim së bashku me ndriçim, me gjatësi prej 250 m. Lagja “Hajdari” të bëhet me kanalizim me gjatësi afër 30 m. Rruga “Qendresa”, “Bataljoni” të dyja me gjatësi prej 150m duhet të asfaltohen, gjithashtu kërkoi që ura në fshatin Bukosh është e dëmtuar dhe kërkoi nga qeverisja të rikonstruohet, gjithashtu kërkoi një AMF të re.

Mentor Vatovci, banor i fshatit Novolan, kërkoi që rruga “Bislim Muzaqi” të bëhet me kanalizim dhe ndriçim me gjatësi 150m. Rruga “Hajriz Bruzniku” të rikonstruohet. Rruga “Sadri Haziri” në Kollë, të bëhet me kanalizim, ndriçim dhe asfaltim. Rruga “Bajram Brahim Bunjaku” të bëhet me asfalt, kanalizim dhe ndriçim – 300m. Rruga “Hajdin Rexhepi” 230m në fshatin Vërnice si dhe “Bislim Sallahu” 140m të asfaltohen dhe të bëhen me kanalizim dhe ndriçim, ku kjo rrugë vazhdon deri në Bukosh deri te rruga “Islam Sallahu”, ku kërkohet që të shtrohet me trotuar dhe të rikonstruohet. Lagja Mehmeti në fshatin Bukosh të bëhet me kanalizim 500-700m. Rruga “4 Martirët” me gjatësi 1.5 km të asfaltohet. Rruga “Arif Rama” me gjatësi 150m kërkesë për asfaltim.

Selatin Shaqiri, banor i fshatit Brusnik, kërkoi që rruga “Besnik Shaqiri” dhe “Hajdin Shaqiri”, dy rrugë që duhet bashkuar të dyja me gjatësi prej 140m.


Ahmet Rexhepi, banor i fshatit Novolan, kërkoi që një rrugë në fshatin Novolan të emërtohet.

Hashim Hajrizi, banor i fshatit Novolan, kërkoi që të bëhet pastrimi i lumit në Novolan.

Mbledhja përfundoi në ora

Procesmbajtës:

Albiona Isa



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2024

07.07.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	Hazir Holi	Hazir Holi	Novolan
2	Fatmir Kovari	Fatmir Kovari	Novolan
3	Hexhmedin Tahiri	Hexhmedin Tahiri	Xherdan
4	Alber Hajrizi	Alber Hajrizi	Novolan
5	Ahmed Rexhepi	Ahmed Rexhepi	NOVOLAN
6	MENTOR VATOVCI	MENTOR VATOVCI	NOVOLAN
7	Islam Latifi	Islam Latifi	Novolan
8	Seladin Shagjiri	Seladin Shagjiri	Prizrenik
9	JARUP FRAZLIU	JARUP FRAZLIU	ROLLË
10	Hashim Hajrizi	Hashim Hajrizi	Novolan
11			
12			
13			
14			
15			
16			



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 07.07.2023, me banorët e këshillit lokal Pantinë, të mbajtur në shkollën e fshatit me fillim nga ora 17:00.

Të pranishëm nga komuna ishin: Benjamin Shala-drejtor për Shërbime Publike, Sylejman Mehollli-asamblist në Kuvendin e Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Benjamin Shala**, drejtor për Shërbime Publike, i cili para qytetarëve të pranishëm prezantoi buxhetin dhe projektet që janë planifikuar për këshillin lokal Pantinë.

Më pas fjala kaloi tek qytetarët e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Kërkesat e banorëve të fshatit Pantinë:

1. Furnizimi me ujë për lagjet Shabani, Imeri dhe lagjen Sejdiu (Probleme për shkak të shtypjes, mosfurnizim).
2. Rruga "Bahtir Rexha" deri në fund të segmenteve, afërsisht 2.4 km. Riasfaltim dhe ndriçimi publik.
3. Problemi i sigurisë së shtyllave elektrike, janë jo të sigurta.
4. Asfaltimi i rrugës dhe lagjja Salihu deri te shkolla gjatësi 170 m, fshati Pantinë.
5. Asfaltimi i rrugës "Zekë Kalludra" segment 150 m.
6. Asfaltimi i rrugës "Shemsedin Xhakolli" dhe "Islam Shabani" afër 900 m.
7. Asfaltimi i rrugës "Dibran Imeri" 400 metra.
8. Pastrimi i shtratit të lumit dhe urat në lagjen Shaqiri, Aliu, Binaku.

Kërkesat e banorëve të fshatit Akrashticë:

1. Riasfaltimi i rrugës kryesore të fshatit "Vullnetari i UÇK-së".
2. Riasfaltimi i rrugës "Qazim Morina".
3. Vazhdimi i trotuarit përgjatë rrugës "Vullnetari i UÇK-së".
4. Rrugica në lagjen "Beka", lagjja "Syla", lagjja "Shala", lagjja "Beqiri", lagjja "Rama", lagjja "Mehmeti", lagjja "Morina".

5. Rruga deri tek varrezat e lagjes "Beqiri".
6. Zgjerimi i shtratit të lumit sipas nevojës.
7. Rikonstruimi i urës kryesore të fshatit deri tek shkolla.
8. Rruga "Hamdi Shala" asfaltim.
9. Asfaltimi i rrugës që lidh fshatin Akrashticë-Pantinë, lagjja Barelitë.
10. Policë të shtrirë në lagjen Osmani-Xhaka.
11. Ndërtimi i katit të dytë në shkollën e fshatit.
12. Zgjerimi i ndriçimit publik në lagjet ku mungon.
13. Asfaltimi i rrugës që lidh fshatit Akrashticë-Shtitaricë, rruga "Komanda e UÇK-së.
14. Rregullimi i rrethojave të fushave sportive.

Kërkesat e banorëve të fshatit Liqej:


1. Asfaltimi i rrugëve në lagjet Bajrami.
2. Rregullimi i rrugës për te varrezat si dhe varrezave 1 km.
3. Rregullimi i urës deri rruga "Sherif Voca".
4. Rregullimi i një fushe sportive.
5. Rregullimi i kanalizimeve në fshatin Liqej.
6. Pastrimi i liqeve.

Kërkesat e banorëve të fshatit Balincë:

1. Rruga kryesore rikonstruim dhe zgjerim.
2. Rregullimi i kanalizimit.
3. Ndriçimi publik-zgjerim.
4. Rregullimi i fushës sportive.

Procesmbajtës:

Benjamin Shala





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 07.07.2023, me banorët e keshillit lokal Smrekonicë, të mbajtur në shkollën e fshatit me fillim nga ora 17:00.

Të pranishëm nga komuna ishin: Isuf Jashari-Drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar, Fortuna Krasniqi-drejtoreshë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe Shkelzen Osmani-asistent i nënkryetarit të komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Isuf Jashari**, drejtor për Buxhet, Financa dhe Thesar, i cili para qytetarëve të pranishëm prezantoi buxhetin dhe projektet që janë planifikuar për keshillin lokal Smrekonicë. Ai informoi qytetarët se prioritet për këtë lokalitet e kanë shtrirjen e rrjetit të kanalizimit dhe të ujësjellësit, po ashtu edhe për punët tjera që do të realizohen gjatë këtij viti.

Më pas fjala kaloi tek qytetarët e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Agim Hashimi, kryetar i fshatit Banjskë, i cili paraqiti këto kërkesa:

1. Intervenim sepse një rrugë në fshat është e bllokuar dhe tha se 100H tokë janë të bllokuar mbi autostradë.
2. Rruga nga stalla e tutje të shtrohet në zhavor.
3. Rruga prej anës së fshatit Sllatinë e deri te autostrada ku tha se nëse nuk ka zhavor vetëm e dërgoni një bager që ta hap rrugën.
4. Rruga "Fatmir Keqolli" të asfaltohet.
5. Rruga "Hajriz Veseli" të asfaltohet.

Emin Ferati, përfaqësues i fshatrave Sllatinë dhe Tërllobuq, i cili i paraqiti këto kërkesa:

1. Rregullimin e ujësjellësit.
2. Ndriçimin e rrugëve.
3. Ndërtimi i trotuareve.
4. Mbjellja e drunjve dekorativ.
5. Rregullimi i dy urave.
6. Emërtimi i rrugëve.

7. Caktimi i vendit të varrezave dhe mirëmbajtja e tyre.
8. Rregullimi dhe ndërtimi i rrugicave me zhavor dhe asfalt në tërë fshatin.
9. Vendosija e rrethojës së shkollës fillore që gjendet në fshatin Sllatinë.
10. Pastrimi i kanaleve-Lumenjve të fshatit.
11. Vendosija e kanalizimit në tërë fshatin.
12. Vendosija e shtyllave të komunikacionit me emërtim të fshatit.

Ai dorëzoi tek përfaqësuesit e Komunës një listë me emërtimin e rrugëve me pëlqim të banorëve, ku ishin gjithsej 10 rrugë me emra të të propozuarve.

Qemail Hasani, përfaqësues i fshatit Smrekonicë, paraqiti kërkesat e banorëve të këtij fshati:

1. Ndriçimi publik në rrugën “Halil Mustafa”.
2. Ndriçimi publik në rrugën “Fehmi Kajtazi” aneks i rrugës “Latif Berisha”.
3. Ndriçimi publik i rrugës “Rrustem Hajdini”.
4. Asfaltimi i rrugës “Ali Hasani” aneks i rrugës së Kçiçit.
5. Asfaltimi i rrugës “Ali Bejta” aneks i rrugës “Latif Berisha”.
6. Asfaltimi i rrugës “Mirsad Mustafa” përballë shkollës “Latif Berisha”.
7. Rregullimi i rrugës “Aziz Bejta” në disa pjesë.
8. Rregullimi i trotuarit në rrugën “Halil Mustafa”.
9. Zhavor për rrugën “Fehmi Mustafa” aneks i rrugës “Rrustem Bejta”.
10. Zhavor për rrugën “Musa Abazi” aneks i rrugës “Latif Berisha”.
11. Zhavor për rrugën “Zeqir Berisha” aneks i rrugës “Aziz Bejta”.

Mbledhja përfundoi në ora 17:45.






Procesmbajtës:

Shkelzen Osmani



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2024

07.07.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	KUSHTRIA BERISHA		SMREKONICË
2	QEMAIL HASANI		SMREKONICË
3	Isa Sadiku		BANJSKË SMREKONICË
4	SHEMSI ISMAJLI		BANJSKË
5	EMIN FERAT		SHIATKE
6	Agim HASHIMI		BANJSKË
7	LIRIDOR HASANI		SMREKONICË
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit të vitit 2024, mbajtur me 10.07.2023 në fshatin Samadrexhë, takimi filloi në orën 17:00,

Të pranishëm ishin: Melihate Basholli Latifi Kryesuese e komitetit për Politikë dhe Financa dhe anëtare e grupit punues, Agron Perçuku anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe njëherit Kryesues i grupit punues, Medina Bunjaku Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe anëtare e grupit punues, Refik Maloku asamblist i Kuvendit Komunal dhe anëtar i grupit punues dhe Shkelzen Osmani nga Zyra e nënkryetarit të Komunës dhe anëtar i grupit punues.

Mungoi zyrtari nga Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Thesar z.Lutfi Gërguri anëtar i grupit punues.

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Rashani, Lulzim Surdulli, Bajram Basholli, Selim Maloku, Shaban Tiku, Emin Basholli, Zejnullah Maloku, Alban Maloku, Ekrem Maloku, Sami Surdulli, Agim Perçuku, Tahir Tashefci, Jetmir Tashefci.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agron Perçuku** njëheri kryesues i këtij grupi punues, i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, dhe i falënderoj për bashkëpunimin e vazhdueshëm deri me sot, dhe i njoftoi të pranishmit lidhur me përmbajtjen e takimit, propozimet të cilat dalin nga ky takimi nuk dmth që nuk mund edhe të ndryshojnë.

Prandaj kërkesat e juaja janë të mirëpritura nga ne, dhe pas përfundimit të dëgjimeve buxhetore të gjitha kërkesat e juaja do të shqyrtohen dhe në bazë të mundësisë do të planifikohen për tu realizuar për vitin 2024.

Melihate Basholli Latifi-Kryesuese e Kuvendit komunal në Vushtrri, i përshëndeti të pranishmit dhe i paraqiti projektet që janë të planifikuar për këto fshatra për këtë vit, ndërtimi i kanalizimi në fshatrat për Samadrexhë -Ceceli -Sllakoc, asfaltimi i rrugës në fshatin Samadrexhë, Renovimi i objektit të SHFMU Lumni Surdulli në fshatin Samadrexhë, **Medina Bunjaku**-Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, përshëndeti të pranishmit dhe ju premtoj pasi që ka marr kërkesat si drejtori nga këshilli i fshatit do ti shqyrtojmë edhe me drejtorinë për Buxhet dhe Financa të shohim mundësin e realizimit të këtyre kërkesave siç janë: parketi i palestrës, rregullimi ngrohtores se palestrës etj.

Muhamet Rashani- kryetar i këshillit fshatit i përshëndeti te pranishmit, i njoftoj për punën dhe organizimet që janë bërë në kuadër të këshillit të fshatit, si dhe paraqiti vërejtjet sa i përket kërkesave të drejtuara komunës së Vushtrrisë ku po hasim në vështirësi në realizimin e këtyre kërkesave siç janë: mungesa e ujit të pijshëm, kërkesën për renovimin e rrugës kryesore ku përgjegjës është Ministria, kërkesa e tyre ka qenë që të procedohet tek ministria përmes komunës një gjë e tillë nuk ka ndodhë tash e sa muaj, për më shumë fjalën ja kalojë **Alban Malokut** për ti propozuar të gjitha kërkesat e projekteve prioritare në emër të këshillit të fshatit.

Projektet prioritare të propozuara për fshatin Samadrexhë për vitin 2024

1. Furnizimi me ujë të pijshëm
2. Instalimi i gypave të kanalizimit në fshat. Sanimi i gypit të kanalizimit në lum, te rruga Shyqyri Rashani
3. Rregullimi i proçkave në fshat, hapja, thellimi dhe zgjerimi i tyre
4. Instalimi i ndriçimit dhe mirëmbajtja e tij
5. Instalimi dhe rregullimi i shtyllave elektrike në rrugën
6. Hapja dhe asfaltimi i rrugës pranë varrezave në hyrje të fshatit me gjatësi 400 metra
7. Rregullimi dhe ndriçimi i fushës së futbollit, basketbollit dhe rregullimi i shkallëve pranë fushës
8. Rihapja e bibliotekës në fshat
9. Mbajtja e mësimit në shkollë me vetëm një ndërresë. Mësim vetëm paradite
10. Zgjerimi i rrugës, Sokol Hyseni, me gjatësi 60m te Gazmend Maloku, që lidhë fshatin Samadrexhë dhe Ceceli
11. Rregullimi i parkut prapa Palestrës Sportive
12. Hapja dhe rregullimi i parkut nga rruga Shyqyri Rashani dhe Hashim Basholli
13. Asfaltimi i rrugës Aziz Surdulli, 300metra
14. Asfaltimi i rrugës, Sokol Hyseni, segmenti 60 metra në lagje
15. Asfaltimi i rrugës, Hasan Beqir Hyseni dhe lidhja me fshatin Sfaraqak 1km
16. Asfaltimi i rrugës, Ismajl Haziri me gjatësi 950m, që bën lidhjen e fshatrave Zagorje, Dumnicë e Mesme, Samadrexhë, Ropicë, Vilancë, KFOR dhe Maxhunaj
17. Vazhdimi i asfaltimit të rrugës, Adem e Ferit Bunjaku
18. Riasfaltimi i rrugës, Emin Rexhep Maloku 1km
19. Vazhdimi i asfaltimit të rrugës, Selman Maloku 170m
20. Vendosja e shtatores së Lumni Surdullit në qytetin e Vushtrrisë

Shaban Tiku- përshëndet të pranishmit pavarësisht asaj që nuk janë këta ata përfaqësues që është dashtë të jenë këtu prezent për të marr premtimin e realizimi e këtyre propozimeve, e falënderon për punën angazhimin e këshillit të fshatit ka disa vërejtje për përfaqësuesit nga ky fshat që janë përfaqësues në asamblenë komunale të cilët nuk e dinë qëllimin e përfaqësimit të këtyre banorëve, por sugjeron këshillin e fshatit që ti shkëpus komunikimin me ta dhe komunën deri në rregullimin e ujit të pijshëm si kërkesë kryesore.

Muhamet Rashani- Dëmtimi i kanalizimit për gjatë lumit akoma nuk është rregulluar pavarësisht kërkesave tona të përditshme komuna akoma nuk ka marr ndonjë veprim për të rregulluar.

Ekrem Merovci- kërkon nga komuna pikërisht nga drejtoresha që të ketë në konsideratë kërkesën e rregullimit të parketit, dhe ngrohjes së palestrës si kërkesa prioritare për arsye se gjatë aktiviteteve të klubit hendbollistik Samadrexha lojtarët po dëmtohen për shkak se shtruarja e gomës në palestër në kohen kur është bërë ndërtimi i palestrës, në atë kohë është bërë edhe devijimi i projektit nga parketi në një shtresë të gomës, dhe sot po hasim në lëndime

të lojtarëve për çka e kemi edhe rekomandimet e mjekëve se nga kjo vijnë edhe lëndimet e gjunjëve e shumë të tjera.

Zen Maloku - Pavarësisht kërkesave të vazhdueshme për të realizua kërkesat tona, tash e disa vite kemi hasë në vështirësi si nga pushteti i kaluar ashtu edhe nga pushteti i tanishëm këtë e dini edhe ju z.Agron që kërkesa ime ka qenë vazhdimi i asfaltimi i rrugës Selman Maloku me gjatësi 170 m si dhe uji i pijshëm.

Selim Maloku- Edhe pse shumë herë ju kam drejtuar organeve përgjegjëse, ende nuk është pare interesimi i organeve përgjegjëse të komunës për zgjidhjen e problemit që unë dhe familja ime kemi, demin qe po na e shkakton uji qe vije si pasojë e reshjeve, dhe i njëjti derdhet në oborrin e shtëpisë dhe atakon direkt murin e shtëpisë, që si pasojë e tërë shtëpia është mykur në muret e brendshme, kështu që vazhdimisht kemi problem shëndetësore e tërë familja.

Arsyeja pse uji grumbullohet dhe derdhet direkt dhe atakon murin e shtëpisë është mos rregullimi i kanalit, dhe ne vendin ku ka qenë kanali me herët komuna e Vushtrrisë ka shtruar trotuar, kështu që nuk ka ndonjë zgjedhje që ne si person fizik mundemi me e zgjedhë.

Andaj edhe njëherë ju kërkoj -lutemi që të merret parasysh kërkesa që ne po ju paraqesim.

Vërejtje: komunikimi në mes te Këshillit të fshatit dhe Komunës është jo i mirë për ti realizuar kërkesat e banorëve të fshatit Samadrexhë, andaj kërkesa është që të ndërpresin komunikimin si këshillë me komunën deri sa të bëhet rregullimi i ujit të pijshëm si kërkesë kryesore dhe imediate për këtë fshatë

Tahir Tashefci nga fshati Ceceli kërkon nga komuna që të kenë konsideratë për kërkesat tona, për arsye se neve si banorë të këtyre lokaliteteve po hasim në shumë vështirësi nga demet që po na shkaktojnë, psh. vërshimet e kohëve të fundit ku na kanë shkaktuar dëme edhe prona private shtëpi, rregullimin e disa shtyllave elektrike që po na rrezikojnë, ndriçimin e lagjes tek varrezat e fshatit ku jetojmë mbi 15 shtëpi, rruga qe i lidhë fshatin Ceceli me tokat që i kemi për ti punuar për shkak të rrugës nuk po mundemi me i punu kërkojmë nga komuna që të bënë hapjen e kësaj rruge.

Agim Perçuku në emër te fshatit Ceceli falënderon komunën për punën dhe angazhimin që është bërë ne fshatin Ceceli dhe njëherësh propozon projektet prioritare për planifikim për vitin 2024.

Projektet prioritare të propozuara për fshatin e Cecelisë për vitin 2024

1. Uji i pijshëm.
2. Hapjen e kanalit skaj rrugës prej Samadrexhës deri ne Sllakoc dhe krasitjen e degëve dhe barit skaj rrugës
3. Një trafo në lagjen e Krasniqëve te varrezat e Cecelisë, ndriçimi i lagjes ku banojnë 15 familje.
4. Ulëse tek lapidari i heronjve të Cecelisë.
5. Pengesa të shpejtësisë në rrugët e fshatit, një pasqyrë te AMF-ja.
6. Rregullimi i rrugës që lidh fshatin Ceceli me Kunevik i dëmtuar nga gurthyysi dhe nga te reshurat atmosferike.
7. Rregullimi i rrugës nga varrezat e Cecelisë deri në kodër tek shtëpitë e Kodralive rrugë e pa kalueshme
8. Pastrimi i proçkës tek varrezat e fshatit Ceceli.

Krejt në fund grupi punues para banorëve të këtyre vendbanimeve që kanë parashtruar pyetje dhe kërkesa, për disa prej tyre kanë marrë zotimin se do të jenë pjesë e buxhetit të komunës për vitin 2024, dhe disa të tjera do të shqyrtohen së bashku me drejtoritë gjegjëse për të qenë pjesë e buxhetit për vitin 2024.

Mbledhja përfundojë në 18:20

Shkelzen Osmani



Procesmbajtës



Agron Perçuku



Kryesuesi i grupit punues



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 10.07.2023, me banorët e këshillit lokal Maxhunaj, të mbajtur në shkollën e fshatit me fillim nga ora 17:00.

Të pranishëm nga komuna ishin: Ergin Sunguri-drejtor për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Bekim Zabërgja-asamblist në Kuvendin e Komunës, Abit Abiti-zyrtar në Drejtorinë për Buxhet, Financa dhe Thesar, Albiona Isa-asistente e Kryetarit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Bekim Zabërgja**, asamblist në Kuvendin e Komunës, i cili para qytetarëve të pranishëm prezantoi buxhetin dhe projektet që janë planifikuar për këshillin lokal Maxhunaj.

Abit Abiti, zyrtar në Drejtorinë për Buxhet, Financa dhe Thesar, tha se i regjistrojnë të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe përpiqemi që t'i përfshijmë në buxhetin e vitit të ardhshëm. Ju lutem që t'i paraqitni kërkesat reale dhe për të cilat ka nevojë komuniteti.

Ergin Sunguri, drejtor për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, tha se ky dëgjim buxhetor është edhe për të gjitha komunitetet jo-shumicë që jetojnë në këtë këshill lokal dhe qëllimi është që t'i përfshijmë të gjitha kërkesat, meqenëse ju qenkeni prej pothuajse të gjitha lagjeve. Kërkesat tuaja do të përpiqemi që t'i përfshijmë në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Më pas fjala kaloi tek qytetarët e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Kadri Maxhuni, përfaqësues i lagjes Kameraj, tha se shqetësim për lagjen tonë është që sa herë bie shi na merr uji. Në lagjen Kameraj dhe Dakiajve si të dalësh nga KFOR-i deri në magjistrale e merr uji tash e 4 vite, rreth 700m gjatësi.

Visar Maxhuni, kryetar i këshillit lokal Maxhunaj, paraqiti kërkesat kryesore, e që tha se ujërat e zeza po përzihen me ujin e pijes. Nën KFOR të gjitha shtëpitë nuk kanë kanalizim. Te shkolla fillore "Rilindja" nuk ka trotuar që 3 vite jemi duke bërë kërkesa pa ndërprerë.

Faik Maxhuni, banor i fshatit Maxhunaj, tha se rruga "Sylejman Maxhuni" është rreth 170 m dhe nuk është asfaltuar. Në vitin 2018 me mjete vetanake e kemi shtruar me zhavorr. Rreth 14 shtëpi janë në këtë rrugë dhe është rrugë publike.

Mehdi Maxhuni, banor i fshatit Maxhunaj, tha se rruga në qendër të fshatit ka mbetur pa u shtruar, vitin e kaluar kemi bërë kërkesë na keni kthyer nuk ka mjete, po flasim për në qendër të fshatit tek trafo, gjatësia rreth 150m. Investime ka pak mos me thënë aspak. Kemi pas takim me KFOR dhe komuna me hap dy kanale që me u derdhë uji, por nuk ka pas reagim.

Tahir Musliu, banor i fshatit Maxhunaj, lagjja e re rruga është e paasfaltuar, 500 m gjatësi dhe 4 m gjerësi tek restorant Ura e Vjetër e Gurit, vjet ka qenë në projekt, por e keni heq apo nuk e di se çka është bërë.

Zeqir Melenica, banor i fshatit Maxhunaj, tha se më së paku është punuar në Maxhunaj. Lagjja e re ujë nuk ka, ndriçim nuk ka, rruga e përmendi edhe Tahir Musliu.

Besim Ajvazi, banor i fshatit Maxhunaj, tha se kanalizimin e kemi ngjit vet, sepse nuk e keni krye kurrë. As asfalt, as ndriçim nuk kemi, jemi 11 shtëpi. 250 m njëra rrugë 350 m tjetra.

Visar Maxhuni, banor i fshatit Maxhunaj, tha se ka shumë kërkesa edhe prej banorëve për një çerdhe për këtë këshill lokal, është shumë e nevojshme. Lokacioni do të ishte në mes të ambulantes dhe zyrës së vendit këtu në Maxhunaj.

Kadri Maloku, banor i fshatit Maxhunaj, tha se lagjja Maloku tash që pat vërshime 4 shtëpive ju ka hy uji brenda. Kanale për menaxhim të ujërave. Për të shikuar ka qenë Komuna, me këqyrë na jemi zotni, por kishe ju si Komunë me ndreq diçka. Kanalizimin e kemi bërë vet privat, por u dëmtu për shkak të ngarkesës së madhe që kanë kyçur dhe ka dalë mbi rrugë. Ata ujë që vërshon mundemi me shti në mes të rrugës me gjithë kanalizim. Lagjaja Maloku, “Sejdi Maloku”, “Xheladin Maloku”, të dyja janë rreth 250 m gjatësi, njërin të paktën me zhvor me e shtru, nuk mundesh me dalë as me kerr, lloq i madh është aty. Edhe një çështje tjetër, çkado që ndan komuna, subvencione sidomos për bujqësi, ne na pyet neve përfaqësuesve të fshatit kapak, ndahen sera ne nuk dijmë asgjë, ndahen diçka për bujqësi nuk dimë asgjë. Kurrë nuk informohemi cka e qysh, vec kur të dëgjojmë që x apo y mori serrë, multikultivator etj. Për çka jemi ne si përfaqësues, kishe mu informu paraprakisht.

Ahmet Zabërgja, banor i fshatit Maxhunaj, tha se për lagjen Zabërgja prioritet është uji i pijshëm, pasi nuk kemi ujë të pijes, me vetura shkojmë në Vushtrri tek qeshmja me marrë ujë. Kërkesa është të na siguronin ujin e pijes. Diga te Mulliri i fshatit është shkatërruar, po ka vërshime.

Bekim Zabërgja, asamblist në Kuvendin e Komunës, tha se ura tek mulliri ka hy në buxhet.

Milazim Hasani, banor i fshatit Ropicë, tha se në lagjen Hasani ujësjellës nuk ka. Rrugën e kanë prish vërshimet. Rruga “Shaqir Hasani”, i ka 650 m, “Kada Hasani 180 m, janë pa asfaltim.

Blerim Igrishta, banor i fshatit Maxhunaj, tha se tek lagjja e re, çka dëgjova unë pothuajse krejt paskan investuar vet me mjete vetanake. Çka po kuptoj Komuna nuk paska investuar hiç. Sa i përket lagjes tonë, krejt investimet janë bërë me mjete vetanake, asnjë investim nuk ka bërë komuna.

Visar Maxhuni, banor i fshatit Maxhunaj, tha se nuk pajtohet me parafolësin Blerim Igrishta, pasi asfaltin kryesor na e ka bërë komuna.

Blerim Igrishta, banor i fshatit Maxhunaj, tha se po flas për lagjen te ura e gurit, krejt kemi investuar me mjete tona. Komuna nuk ka ndërhy kurrë. Lagjja e re, 16 shtëpi janë, askund nuk ka investim të komunës.

Arsim Maxhunaj, banor i fshatit Maxhunaj, tha se jeton në Zvicër dhe vërshimet që kanë ndodhur para 4 viteve ma ka marrë shtëpinë uji, tash prapë, komisionet komunale kanë dalë e kishe i kanë regjistruar dëmet, por nuk u bërë diçka me na ndihmu kurrë, arsyeja nuk kemi buxhet. Tjetra, vendin e keni rrafshu po fushën e futbollit nuk e keni bërë. Pastrim nuk ka, mbeturina në të gjitha anët nëpër shat, bari i madh rreth rrugëve. Te ambulanta rrethojat janë dëmtuar dhe kurrë nuk pastrohet oborri, është në gjendje të tmerrshme. Nuk ka gjelbërim, nuk ka në

mbrëmje me luajt fëmijët tanë, të argëtohen, se nuk e keni rregullu fushën. Marre po më vjen në fshat me hi.


Abit Abiti, zyrtar në Drejtorinë për Buxhet, Financa dhe Thesar, tha se vjet kemi qenë në dëgjime, por nuk ka pas asnjë pjesëmarrës, nuk ka projekte që kanë hy se nuk ka pas pjesëmarrës. Ishalla i kryejmë krejt.

Visar Maxhuni, banor i fshatit Maxhunaj, tha se nëse këto projekte/kërkesa nuk kryhen, vitin e ardhshëm unë jap dorëheqje si kryetar i këshillit. Shekulli 21 me fol për këto gjëra kanalizim, ujë, vërsime rreth 60 shtëpi jemi krejt të banueshme, po tmerr është.

Mbledhja përfundoi në ora

Procesmbajtës:

Albiona Isa



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetorë për buxhetin e vitit 2024

10.07.2023

Nr.	Emri dhe mbiemri	Nenshkrimi	Vendi
1.	Visar Maxhuni	Maxhuni	Maxhunj
2.	YLIBER MAXHUNI	Maxhuni	MAXHUNAJ
3.	SUAD MAXHUNI	Maxhuni	MAXHUNAJ
4.	Besim HIRAZI	BE	1-11-11
5.	ZEQIR-MELENI	ZE	MAXHUNAJ
6.	ADEM MAXHUNI	AMaxhuni	MAXHUNAJ
7.	Ahmet Zolceff	AZ	Udhëheqës
8.	Kadri Maloku	KM	1-1-1
9.	Blenim Igriq	BI	MAXHUNAJ
10.	Tahir Musliu	TM	MAXHUNAJ
11.	Milazim Hasani	MH	Topice
12.	Mehdi Murrkari	MM	Maxhunj
13.	Arianit Jankari	AJ	Shoqë-Vashitari
14.	KADRI MAXHUNI	KM	MAXHUNAJ
15.	ARSJON MAXHUNI	AM	MAXHUNAJ
16.	FORK MAXHUNI	FM	MAXHUNAJ



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 11.07.2023, me banorët e këshillit lokal Nedakoc, të mbajtur në shkollën e fshatit me fillim nga ora 19:00.

Të pranishëm nga komuna ishin: Maliq Ferizi-drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim, Ilmi Azemi-asamblist në Kuvendin e Komunës, Gresa Muli-asambliste në Kuvendin e Komunës, Abit Abiti-Drejtorja për Buxhet, Financa dhe Thesar, Shkelzen Osmani-asistent i nënkryetarit të komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Ilmi Azemi**, asamblist në Kuvendin e Komunës, i cili para qytetarëve të pranishëm prezantoi buxhetin dhe projektet që janë planifikuar për fshatin Nedakoc. Po ashtu, i informoj të pranishmit që gjatë këtij viti do të përfundojë çështja e ujit të pijes dhe kanalizimi për këtë fshat.

Më pas fjala kaloi tek qytetarët e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Enver Makiqi, banor i fshatit Sfaraqak i Ulët, përshëndeti të pranishmit dhe kërkoi që të asfaltohet rruga “Zejnullah Makiqi” në fshatin Sfaraqak i Ulët me gjatësi 300m, ku tha se rruga është publike dhe tha se ka ankesa të shumta për organet kompetente rreth kësaj rruge.

Ilmi Azemi, asamblist në Kuvendin e Komunës, premtoi publikisht se në vitin e ardhshëm do të asfaltohet kjo rrugë.

Bajram Veseli, banor i fshatit Sfaraqak, kërkoi asfaltimin e rrugëve “Kajtaç Veseli” me gjatësi 260m në Sfaraqak të Ulët, rrugën “Shashivar Musa” 300m dhe rrugën “Miran Xhafa” me gjatësi 160m.

Ilmi Azemi, asamblist në Kuvendin e Komunës, pyeti nëse janë këto rrugë publike.

Bajram Veseli, banor i fshatit Sfaraqak, tha se këto rrugë nuk janë publike.

Komisioni i njoftoi të pranishmit se rrugët që nuk janë publike nuk guxojnë të ndërhyjnë.

Safet Dushi, banor i fshatit Sfaraqak, kërkoi asfaltimin e rrugës “Riza Dushi” në Sfaraqak të Ulët me gjatësi 250m dhe tha se me sa ka informacione është rrugë publike. Gjendja e kësaj rruge është e rëndë dhe duhet të shtrohet me zhavorr, është mese e nevojshme që të ndërhyhet.

Liridon Imeri, banor i fshatit Sfaraqak, kërkoi asfaltimin e rrugëve “Bajram Mulliqi” dhe “Mahmut Imeri” 200m në Sfaraqak të Epërm.

Ilmi Azemi, asamblist në Kuvendin e Komunës dhe **Abit Abiti**, nga Drejtorja për Buxhet, Financa dhe Thesar, e informuan se kjo rrugë gjendet në listën e rrugëve që do të asfaltohen këtë vit dhe për rrugën tjetër “Mahmut Imeri” propozuan shtrim me zhavorr në këtë vit.

Faruk Ferizi, banor i fshatit Pestovë, propozoi asfaltimin e rrugës “Imer Ferizi” që lidh Nedakocin me Pestovë 2km e gjatë dhe rrugën “Nystret Ademi” 2km e gjatë prej Vipa Chips e poshtë. Po ashtu, ngriti si çështje edhe trotuarin në rrugën “Shaban Polluzha” 560m në rrugën kryesore të fshatit Pestovë.

Mehmet Ferati, banor i fshatit Sfaraqa, kërkoi asfaltimin e rrugës “Abedin Ferati” me gjatësi 320m në fshatin Sfaraqak i Ulët, po ashtu kërkoi ndërtimin e trotuarit në rrugën kryesore të fshatit Sfaraqa nga magjistranja e përgjatë rrugës “Miran Xhafa” 3600m në këtë vit, e pjesën tjetër më vonë. Po ashtu, kërkoi edhe ndërtimin e një çerdheje për këtë lokalitet.


Semir Zeqiri, banor i fshatit Nedakoc, kërkoi intervenim në rrugën nga fshati Nedakoc e deri tek Bankinat vetëm me zhavorr.

Maliq Ferizi, drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim, premtoi intervenim me bager në këtë vend.

Mbledhja përfundoi në ora 19:55.

Procesmbajtës:

Shkelzen Osmani



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2024

11.07.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	BAJRAM		Sforogoh
2	KUSHTRIM VESELI		Sforogoh
3	LEUTRIM VESELI		Sforogoh
4	Mehmet Ferizi		Sforogoh
5	FARUK FERIZI	Ferizi	PESTOVË
6	Rafik Mustaj		Starazak
7	Yusuf Inani		Sforogoh
8	SEJDIR ZERIRI		INGOARDUC
9	BEKIM DAKA		STARAZAK
10	ENVER MUKOPI		Sforogoh
11	SABRI FERIZI	Ferizi	STARAZAK
12	FEIM SALIU		PESTOVË
13	ARXHEN ADEMI		PESTOVË
14	JAKUP SALIU		PESTOVË
15	SAFET DUSHI		SFAKORAK SFAKORAK
16			



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRISË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 11.07.2023, me banorët e këshillit lokal Prelluzhë, të mbajtur në shkollën e fshatit me fillim nga ora 20:00.

Të pranishëm nga komuna ishin: Ferit Idrizi-Kryetar i Komunës së Vushtrrisë, Ilmi Azemi-asamblist në Kuvendin e Komunës, Ergin Sunguri-Drejtor për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Maliq Ferizi-Drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim, Branislav Vuksanovic-Shef i Zyrës lokale për komunitete në Komunën e Vushtrrisë, Abit Abiti-zyrtar nga Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Thesar.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Ilmi Azemi**, asamblist në Kuvendin e Komunës, i cili para qytetarëve të pranishëm prezantoi buxhetin dhe projektet që janë planifikuar për këshillin lokal Stroc.

Ferit Idrizi, kryetar i Komunës së Vushtrrisë, i njoftoj banorët për projektet dhe njëkohësisht kërkoi që qytetarët t'i japin propozimet për projekte për vitin 2024.

Branislav Vuksanovic, Shef i Zyrës lokale për komunitete në Komunën e Vushtrrisë, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje dhe kërkoi nga ta që të kenë propozime konkrete.

Më pas fjala kaloi tek qytetarët e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Spasoje Stefanovic, banor i fshatit Prelluzhë, i cili propozoi që të bëhet rikonstruimi i rrugëve të cilat kanë pësuar nga vërshimet. Rikonstruim i rrjetit të ujësjellësit, rikonstruim i kanalizimeve, caktimi i lokacionit të deponisë, asfaltimi i rrugës “Desanke Maksimovic”, “Labska”. Në rrugën “Trg Palih Boraca”, “Cara Lazara”, uji. Me zhavor të shtrohen rruëgët “Milosa Obrenovica”, “Tomicka”, “Stojadina Terentica”, “Branka Radicevica”. Trotuari të bëhet në rrugën “Milosa Obilica”. Vendorsja e policëve të shtrirë me qëllim të rritjes së sigurisë në trafik. Rregullimi dhe pastrimi i kanalit kullues, ura mbi lumin Silnica të rikonstruohet.

Nermin Shaqiri, banor i fshatit Prelluzhë, pyeti lidhur me kanalizimin i cili është në ndërtim e sipër dhe kërkoi ndërtimin e rrugës “Romska” dhe “Bivoljacka”, si dhe kërkoi që të rregullohet ndriçimi publik me 5 drita.


Haxhi Emini, banor i fshatit Prelluzhë, sqaroi se kanë filluar të realizohen projektet dhe kërkoi ndërtimin e një fushe sportive.

Bojkovic Gradini, banor i fshatit Prelluzhë, së pari e falënderoi kryetarin që ka filluar me investime, ai paraqiti kërkesën për ndërtimin e një fushe sportive, dhe kërkoi rregullimin e një rruge që dërgon tek arat me qëllim që të krijohen kushte për korrje. Kërkoi mirëmbajtjen e fushave sportive dhe mjete për funksionalizimin e klubit sportiv.

Branislav Vuksanovic, Shef i Zyrës lokale për komunitete në Komunën e Vushtrisë, njëherësh banor i fshatit Prelluzhë, kërkoi ndërtimin e një bankine bri lumit “Llap” dhe rregullimin e shtratit të lumit “Llap” ose studim se si duhet të procedohet me qëllim të rregullimit të çështjes së vërshimeve.

Procesmbajtës:

Abit/Abiti

A handwritten signature in blue ink, consisting of a series of loops and a final circular flourish, positioned to the right of the printed name 'Abit/Abiti'.

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2024

11.07.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	Clifford Hurdan	Clifford	Tirane
2	Sokol Muson	S. M	Tirane
3	ZORANKOVIĆ KEBOSTA	Z. K	PRILUŽJE
4	Недојан Арманд	H. A	Tirane
5	БОГДАН КОВАЧЕВИЋ	Bojan	PRILUŽJE
6	Xhem Emin	Xh. E.	PRILUŽJE
7	ABEDIN MEHMETI	A. M.	PRILUŽJE
8	NEZIR SHAGIRI	Nezir	PRILUŽJE
9	Арманд Сонко	S. A.	Tirane
10	SPASOJE STEFANOVIĆ	P. Stefanović	PRILUŽJE
11	Mark Tar	Mark	PRILUŽJE
12	Arion KASHANI	Arion	ACCOS
13	B. ARMAND	B. Arm	TIRANE
14			
15			
16			



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 11.07.2023, me banorët e këshillit lokal Stanoc i Epërm, të mbajtur në shkollën e fshatit me fillim nga ora 17:00.

Të pranishëm nga komuna ishin: Ilmi Azemi-asamblist në Kuvendin e Komunës, Nuriye Halili-asambliste në Kuvendin e Komunës, Faton Hyseni-asamblist në Kuvendin e Komunës, Ymer Haradinaj-asamblist në Kuvendin e Komunës, Mensur Kosumi-asamblist në Kuvendin e Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Nurie Halili**, asamblist në Kuvendin e Komunës, e cila i njoftoi qytetarët me rendin e ditës dhe qëllimin e takimit për dëgjime publike buxhetore për vitin 2024.

Faton Hyseni, asamblist në Kuvendin e Komunës, i njoftoi qytetarët, pjesëmarrësit për projektet kapitale që parashihen të realizohen këtë vit 2023.

Më pas fjala kaloi tek qytetarët e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Rrahim Ajeti, kryetar i Këshillit Lokal Stanoc i Poshtëm-Lumadh, i paraqiti dy kërkesa me shkrim, një për Stanoc të Poshtëm dhe një për Lumadh.

Kërkesat për fshatin Stanoc i Poshtëm: Asfaltimi i rrugëve lokale 3000 metra gjatësi, rrugë të rendit të 4-të 6000 metra gjatësi, trotuar 2000 metra gjatësi dhe shtegu i biçikletave, ndërtimi i urës në lagjen e Duraku, kanalizim 2500 metra gjatësi, ndriçim publik 1200 metra gjatësi (apo 50 drita), intervenim të shpejtë në stafin e shkollës ku nuk mbahen orët mësimore me rregull nga arsimtarët dhe ndërrimi i menjëhershëm i menaxhmentit të shkollës dhe shtimi i një aneksi, pasi që çdo vit po rritet numri i nxënësve të shkollës në fshatin tonë, rregullimi i dy fushave sportive, njëra në lagjen e Prekazi dhe tjetra tek shkolla, rregullimi i çerdhes për fëmijët, rregullimi i një parku tek “Ledina e ulët”.

Kërkesat për fshatin Lumadh: trotuar 1000 metra gjatësi, rregullimi i rrethojës së shkollës e cila ka mbetur në gjysmë, ura në tri përrockat e fshatit, pastrimi i përronjve, kanalizim 1000 metra gjatësi, kyçja në sistemin e ujit të pijshëm në lagjen “Hetemi”, rrugë për asfaltim 1500 metra gjatësi, një kënd të lodrave tek oborri i shkollës, ura e lumit “Llap”, rrugë të rendit të 4-të 1500 metra gjatësi.

Hasan Maloku, banor i fshatit Stanoc i Epërm, kërkoi të vazhdohet rregullimi i trotuarit në rrugën “Dalip Maloku” dhe të eliminohet defekti në dritat e ndriçimit.

Mensur Kasumi-asamblist në Kuvendin e Komunës, tha se do të bëhet rregullimi i ujërave të zeza, zgjerimi i shtretërve të tri përronjve, Cakajt, Haradinaj dhe Gracë, po në këtë vit, pra në 2023.

Ismet Kosumi-banor i fshatit Stanoc i Epërm, u shpreh i pakënaqur me investimet kapitale që janë bërë në Stanoc të Epërm dhe Gracë. Stanoci i Epërm është fshati më i madh në komunë, prandaj edhe investimet duhet të jenë më të mëdha.

Bashkim Shala, banor i fshatit Stanoc i Epërm, kërkoi të vazhdohet ndriçimi i rrugës “Behë Shala” dhe të rregullohet rruga “Jakup Shala” dhe “Sami Shala”.

Avdyl Bajqinovci, përfaqësues i fshatit Gracë, kërkoi të rregullohet ujësjellësi, kanalizimi i ujërave të zeza dhe rrugët e lagjeve.

Ferki Pronaj, banor i fshatit Stanoc i Epërm, kërkoi të rregullohet kanalizimi në lagjen Pronaj.

Ilmi Azemi, asamblist në Kuvendin e Komunës, deklaroi se në vitin 2023/2024 është prioritet i qeverisë komunale rregullimi i ujësjellësit dhe kanalizimit në tërë territorin e Vushtrrisë.

Valon Haradinaj, banor i fshatit Stanoc i Epërm, paraqiti kërkesën që në rrugën “Dalip Maloku” të vendosen polic të shtrirë apo pengesa për shkak të rrezikimit të kalimtarëve e sidomos nxënësve.

Ymer Haradinaj, si banor i fshatit Stanoc i Epërm, paraqiti kërkesën për rregullimin e urës në lagjen Haradinaj në rrugën “Mirvete Haradinaj”, pastrimin e varrezave, rregullimi i ndriçimit të rrugëve aty ku kemi shtylla elektrike, rregullimi i kanalizimeve në lagjen Pronaj dhe Haradinaj, rregullimi i trotuarit në rrugën “Dalip Maloku” dhe “Bahri Cakaj”, rregullimi i rrugës tek shkolla Faik Pronaj, rregullimi i rrugëve tek Bislim Pronaj, Xhafer Pronaj, Murat Sopjani, Shefqet Haradinaj, Naser Haradinaj, Daim Haradinaj, Sahit Kosumi, Veli Maloku, Besim Maloku, Arsim Maloku, Lavdim Maloku, Avni Bregaj, rregullimi i dy parqeve rekreative-sportive një në lagjen Bregaj, Hasani, Ibrahim, Aliu, Haradinaj, Shala dhe një tek lagjja Kosumi, Haxhaj, Haradinaj.

Faton Hyseni, si banor i fshatit Stanoc i Epërm, paraqiti kërkesën për rregullimin e rrugës-trotuarit “Sadik Malaj”.

Ramadan Cakaj, banor i fshatit Stanoc i Epërm, kërkoi të rregullohet rruga e Rrahim Cakës dhe Enver Cakës.

Istref Shala, banor i fshatit Stanoc i Epërm, kërkon të rregullohet rruga e Rexhep Shalës, Remzi Shalës dhe të vazhdohet aneksi i rrugës “Sahit Shala” për Shemsi Shalën, Gani Shalën, Nexhat Shalën.

Fehmi Shala, kryetar i Këshillave lokale Stanoc i Epërm dhe Gracë, kërkoi që së pari të fillojë rregullimi i ujësjellësit, pra furnizimi me ujë të pijshëm. Të vendosen 4 pompa për familjet të cilat janë në lartësi dhe nuk furnizohen me ujë. Të rregullohet bazeni në vendin e ashtuquajtur “Vërthana”, që është pika më e lartë në Stanoc të Epërm dhe mund të furnizohen të gjitha familjet me ujë me rënie të lirë. Të vazhdohet rregullimi i rrugës “Vjena” deri tek rruga “Kadri Haradinaj”. Të rregullohet shtrati i tri përrockave në lagjen Cakaj, Shala, Maloku, Prronaj, Haradinaj dhe në fshatin Gracë. Të rregullohen kanalizimet në të gjitha lagjet e fshatit Stanoc i Epërm dhe Gracë. Të dalë inspektorati dhe t’i verifikojë kyçjet e stallave se a janë të kyçura në kanalizim. Të rregullohet ura tek rruga “Mirvete Haradinaj” në lagjen Haradinaj. Të rregullohet rruga me zhavorr-aneks i rrugës “Dalip Maloku” tek ferma e Faik Prronaj. Të rregullohet trotuari në rrugën “Amerika”, të rregullohet trotuari në rrugën “Bahri Cakaj”, të

vazhdohet rregullimi i trotuarit në rrugën “Dalip Maloku” deri tek lagjja Ajvazi, të rregullohet rruga e “Dëshmorëve” dhe të lidhet me lagjen Cakaj dhe Zenovit.

Halim Caka, banor i fshatit Stanoc i Epërm, kërkoi të rregullohen rrugët: “Halim Cakaj”, “Selatin Cakaj”, “Fatmir Cakaj” “Milazim Cakaj”, Hetem Cakaj”, Muhamet Cakaj”, “Bislim Cakaj”, “Enver Bajram Cakaj”, “Qerim Bajram Cakaj”, “Ibush Cakaj”.

Procesmbajtës:





Fehmi Shala

Kryetar i Këshillit Lokal Stanoc i Epërm dhe Gracë



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2024

11.07.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	RAMADAN ÇAKAJ		STANOC
2	RAMDAN ÇAKAJ		STANOC
3	Hasan Çaka		Stonore
4	SAMI BLLACA		STANOCË
5	HASAN MALOKU		Stonore
6	Fehmi Shala		STANOC
7	Ismet Kallaku		STANOC
8	ANDYK BAJQIRI		STANOC
9	RAHIM AJDUTI		STANOC, POSHTË LUMASH
10	VALON HASREDDIN		STANOC I EPËRM
11	Driton Bygju		GRACE
12	Danjeta Duraku		Stanoc i Poshtëm
13	Blexita Duraku		Stanoc i Poshtëm
14	Jehona Berisha		Stanoc i Poshtëm
15	BASHKIM SHALLA		STANOC I EPËRM
16	ISTEF SHALLA		STANOC I EPËRM
17	FERRI PRONA		S. I EPËRM

17. Armanit Jashari



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 12.07.2023, me banorët e këshillit lokal Skromë, të mbajtur në shkollën e fshatit me fillim nga ora 16:30.

Të pranishëm nga komuna ishin: Isuf Jashari-drejtore për Buxhet, Financa dhe Thesar, Ilmi Azemi-asamblist në Kuvendin e Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Ilmi Azemi**, asamblist në Kuvendin e Komunës, i cili para qytetarëve të pranishëm prezantoi buxhetin dhe projektet që janë planifikuar për këshillin lokal Skromë.

Më pas fjala kaloi tek qytetarët e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Astrit Feka, kryetar i Këshillit lokal Skromë, Karaçë dhe Vesekoc, i cili propozoi asfaltimin e rrugës “Kadri Karaq” rrugë e rendit të IV 500m, rruga “Qamil Feka” rrugë e rendit të IV 500m, rregullimi i rrugës kryesore të Skromës pasi që është demolu nga vërshimet, asfaltimi i rrugës “Adem Ademi” 500m, asfaltimi i rrugës “Ajet Braha” rrugë e rendit të IV deri në fshatin Skromë.

Enver Latifi, përfaqësues i fshatit Bozhlan, kërkoi rikonstruim të rrugës “Rrezja” 50m, rikonstruim i rrugës “Te livadhet”, ndërsa kërkoi që për zhvillim të turizmit të hapen shtigje.

Astrit Krasniqi, përfaqësues i fshatit Kurillovë, kërkoi që të bëhet asfaltimi i rrugës Vesekoc-Kurillovë, rruga Sllakoc-Kurillovë, si dhe rrugët e rendit të IV të hapen.

Procesmbajtës:

Isuf Jashari

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2024

12.07.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	Ilir Haxhi		
2	Isuf Jeta		SKEDOR
3	Bujar Pellumbi		
4	Mehmet Hymeri		
5	Fadil Dardesi		
6	ENVER LITA		
7	Astir - Feka		
8	Samir		
9	Naser Latifi		
10	Astir Karaca		
11	Visar Hyseni		
12	Albin Feka		
13	Harhi Feka		
14			
15			
16			



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 12.07.2023, me grupe të ndryshme të grave nga Komuna e Vushtrrisë, të mbajtur në objektin e Kuvendit Komunal me fillim nga ora 17:00.

Të pranishme nga komuna ishin: Melihate Basholli-Kryesuese e Kuvendit, Albiona Isa-Zyra e kryetarit, Fortuna Krasniqi-Drejtoreshë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Donjetë Latifi-Zyra e kryesueses së Kuvendit, Medina Bunjaku-Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, Mirjeta Duraku-Zyra për Informim.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Melihate Basholli**, Kryesuese e Kuvendit të Komunës, e cila i njoftoi qytetarët me rendin e ditës dhe qëllimin e takimit për dëgjime publike buxhetore për vitin 2024 dhe i njoftoi për projektet kapitale që parashihen në vitin 2023.

Më pas fjala kaloi tek pjesëtarët e pranishme, të cilat i paraqitën kërkesat e tyre.

Nerxhivane Krasniqi, nga fshati Zhilivodë, përfaqësuese e grupit joformal të grave nga IADK, kërkoi mbështetje më të madhe për këtë grup si dhe udhëtimi i këtyre grave të paguhet nga komuna.

Medina Bunjaku, drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, u përgjigj duke thënë se forma e vetme për pagesë të organizatave apo subvencionim është nëpërmjet thirrjes publike për subvencionim të OJQ-ve.

Nexhivane Krasniqi, nga fshati Zhilivodë, tha se fshati i saj ka probleme me transportin dhe nuk ka ndriçim.

Fikrije Ferizi, nga Vushtrria, tha se asnjë nga kërkesat e parashtruara nga OJQ e saj, nuk është realizuar si dhe shtoi se sa herë ka aplikuar nuk ka marrë shuma të mjaftueshme për t'i realizuar aktivitetet e organizatës, si dhe shtoi që kërkesa e saj për ekskursion nuk i është aprovuar.

Vildane Mulaku, nga Vushtrria, propozoi të hapen byje nëpër shkolla për gratë e grupit joformal.

Ymrije Beqiri, nga Vushtrria, propozoi që të hapen kënde të leximit nëpër çerdhe, në mënyrë që të bëhej më atraktive dhe tek fëmijët të zhvillohej zakoni i leximit.


Ajete Tahiri nga OJQ "Zgjimi"- tha se është e papunë që nga pandemia, ka punuar në një shkollë në byje por që tani më nuk punon, si dhe kërkoi që t'i bëhej një vend për punë.

Fikrije Ferizi, pyeti nëse rruga për te varrezat në fshatin Begaj është në listën e projekteve.

Fortuna Krasniqi, drejtore për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, tha se kjo rrugë është në listën e projekteve dhe së shpejti pritet të fillojnë punimet.

Procesmbajtëse:

Albiona Isa



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2024

12.07.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	Romir Bekdi	Rhmi	Matinej
2	ATGJE TAHIRI Biri		KOUKAR
3	Fikrije Feuz.	Ffeuz	Vushtrri.
4	Glorjoni Krasniqi	G. Krasniqi	Zhilivodë
5	Kerxhivane Krasniqi	Krasniqi	Zhilivodë
6	Veldane Melaku	V. Melaku	Vushtrri
7	Imrije Begu	Imrije Begu	Vushtrri
8	Donjetë Latifi	Donjetë Latifi	Pestovë
9	XHEVRISJE IMER	XHEVRISJE IMER	VUSHTRRI
10	Albiona Isq	Albiona Isq	VUSHTRRI
11			
12			
13			
14			
15			
16			



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 14.07.2023, me sportistë, rini dhe komunitetin artistik, të mbajtur në Sallën e Kuvendit të Komunës me fillim nga ora 19:00.

Të pranishëm nga komuna ishin: Medina Bunjaku-Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, Benjamin Shala-Drejtor për Shërbime Publike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Medina Bunjaku**, Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, e cili para të pranishmëve prezantoi buxhetin dhe projektet që janë planifikuar për fushën e sportit, kulturës dhe për rininë.

Më pas fjala kaloi tek pjesëmarrësit e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Edis Ternava, nga shkolla e futbollit FC Forca, tha se fusha FC FORCA që ka mbi 150 fëmijë duke ushtruar, nuk është bërë pranimi teknik. FFK-ja na ka thënë që nuk mundemi me organizu garat. Fusha ne Doberllukë rreth 700 fëmijë janë të regjistruar. Nuk kemi kushtet elementare kanalizim jo, ujë jo, infrastrukture nuk kemi. Nëse nuk intervenoni këtë vit, na duhet me ndërpre krejt stërvitjet.

Ramadan Rashani, nga Shoqata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ "Sitnica", tha se përfaqëson 150 peshkatarë dhe e dorëzoi një kërkesë fizikisht.

Arianit Jashari, nga organizata ACCESS, kërkoi që të bëhet ndërtimi i pikave informuese kulturore në qendër dhe përreth qytetit (Digital info signage). Janë kabina kreative, me harta dhe informacione në mënyrë digjitale, të cilat do të shërbenin si pika informuese dhe orientimi. Meqenëse Komuna ka toka në pronësi të veten dhe nuk i shfrytëzon për asgjë, konsideroj se ndërtimi i një qendre rekreative sportive në periferi të qytetit do të ishte investim shumë i qëlluar, ku fëmijët dhe të rinjtë do të mund të zhvillonin aktivitete rekreative, sportive, kamping, etj.

Arbër Hoxha, pyeti se pse Hamami i qytetit nuk është i qasshëm për vizitorët.

Olta Kalludra, fushat e beachvoleyball nuk kanë zhveshtore dhe tush.

Irfan Hasani, shkolla e tenisit "Vushtrria", tha se Vushtrria nuk ka fushë tenisi, të ndërtohet një fushë tenisi sepse interesimi është shumë i madh.









Mbledhja përfundoi në ora 20:00

Procesmbajtës:

Mirjeta Duraku

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2024

14.07.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	Xhavit Mehmeti		Vushtrri
2	Yusef Shomun		Vushtrri
3	RAMADAN RASHIDI		VUSHTRRI
4	Arber Hoxha		Vushtrri
5	Adriat Shteti		Vushtrri
6	Arianit Jashari		
7	Olta Kalludra		Vushtrri
8	ARILIND RASHICA		Vushtrri
9	ASTRETI SAKIHI		VUSHTRRI
10	HAJRUULLAH DUSHI		ECCLASICO
11	EDIS TERNAVA		FC FORCA
12			
13			
14			
15			
16			



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024, të mbajtur me 14.07.2023, me banorët e qytetit(lagjet urbane), të mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim nga ora 14:00.

Të pranishëm nga komuna ishin: Isuf Jashari-drejtore për Buxhet, Financa dhe Thesat, Fortuna Krasniqi-drejtoreshë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Medina Bunjaku-drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport, Bujar Pllana-drejtore për Inspektime, Benjamin Shala-drejtore për Shërbime Publike, Hava Mlinaku-drejtoreshë për Administratë, Shkelzen Osmani-asistent i nënkryetarit të komunës, Agron Përçuku-asamblist në Kuvendin e Komunës dhe Bekim Zabërxha- asamblist në Kuvendin e Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **z.Isuf Jashari**, drejtore për Buxhet, Financa dhe Thesar, i cili para qytetarëve të pranishëm prezantoi buxhetin dhe projektet që janë planifikuar në qytet. Ai u shpreh i pakënaqur me pjesëmarrjen e qytetarëve në këtë takim ku do të diskutohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024. Jashari tha se shtrirja e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit në çdo cep të territorit të Komunës së Vushtrrisë do të jetë prioritet.

Më pas fjala kaloi tek qytetarët e pranishëm, të cilët i paraqitën kërkesat e tyre.

Burim Jashari-kryetar i Lagjes Urbane Kalaja, përshëndeti të pranishmit dhe paraqiti kërkesat e tij, e që ishin:

1. Salla e Sportit ne SHMU-2 të përfundohet.
2. Vendosja e pasqyrave në rrugët ku pamja nuk është e mirë.
3. Ashensorët në banesa publike.
4. Asfalti i prerë për intervenime në rrugë të kthehet prapë në gjendjen që ishte sepse nuk po rregullohet siç ishte pasi po përfundohet me intervenim.

Brahim Manovi, banor i fshatit Duboc i cili i përshëndeti të pranishmit dhe paraqiti kërkesat e tij:

1. Asfaltimi i rrugës në lagjen Manovi në fshatin Duboc e gjatë 120m.
2. Muri mbrojtës urgjent ne rrugën “Mehmet Mehmeti” në fshatin Duboc.
3. Asfaltim i rrugës në lagjen Xhema 110m.
4. Asfaltim i rrugës në lagjen Zuqaku.

5. Asfaltimi i rrugës “Shashivari” 110m.

Xhevdet Barlieva, kryetar i lagjes Urbane Ura e vjetër e Gurit ku paraqiti kërkesat e banorëve të kësaj pjese të qytetit:

1. Ndërtimi i fushës së sportit afër Xhamisë te Bajskalitë në dalje të qytetit për Mitrovicë, konkretisht në Lagjen Hazir Xhaka.
2. Ndriçimi i qytetit, konkretisht rruga “Skënderbeu”.
3. Drunjtë dekorativ në rrugën “Hazir Xhaka”.
4. Vendosja e policëve të shtrirë përgjatë rrugës “Skënderbeu”.
5. Mirëmbajtja e shëtitores Enver Zymberi.

Fejzullah Zeqiri, përfaqësues i lagjes urbane Silnica, ku i paraqiti kërkesat e banorëve të kësaj pjese të qytetit:

1. Rruga “Kadri Zeka” dhe “Hamit Hyseni”, rrugë të dëmtuara dhe vendosja e policëve të shtrirë afër shkollës “Naim Frashëri”.
2. Rruga “Lidhja e Lezhës” vendosja e policëve të shtrirë në këtë pjesë.

Mbledhja përfundoi në ora 15:00


Procesmbajtës:

Shkelzen Osmani



Lista e pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2024

14.07.2023

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendi
1	FEUZI VHEMAJZI		KAZAJA VUSHTR,
2	BURIM JASHAR		KALAJA VUSHTR.
3	TCRIK HYSENI		KALAJA
4	Bratini Pona		QUBOK.
5	Xherdet Bambara		Unë e jetës e juve
6	Fejzullah ZEQIRI		SILNICA
7	HISEN HODAN		QENDRA
8	Armanit Jashari		
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			